



Lajme nga 2022

Gjatë vitit të kaluar UBF njohu disa ndryshime në statut me qëllim përmirësimin e funksionimit të shoqatës dhe efektivitetit në vendimmarrje, si dhe të demokratizimit të mëtejshëm të jetës së brendshme.

Gjithashtu, anëtarët e shoqatës votuan për Bordin e ri drejtues dhe Presidentin e ri për mandatin e ardhshëm. Anëtarët e Bordit të ri janë Alkida Kreka, Florian Marku, Gridi Bozdo, Ilir Shehu dhe Elvis Kena. President i shoqatës u zgjodh Dorian Sadiku.

Partneriteti me GIRP



Ky është vetëm hapi i parë para anëtarësimit me të drejta të plota. Anëtarësimi në GIRP është me rëndësi për shkak të vjeljes së ekspertizës, informacioneve dhe krijimit të kontakteve me partnerë ndërkombëtare, si edhe për përgatitjen për të hyrë në tregun european teksa Shqipëria po vijon procesin e anëtarësimit në BE.

Anëtarësimi merr një rëndësi edhe më të madhe në dritën e zhvillimeve të fundit gjeo-politike, të cilat do të kenë impakt te biznesi, që nga prodhimi e furnizimi e deri te shpërndarja e shitja e produkteve shëndetësore.

UBF me faqe të re zyrtare

www.ubf.al

Shoqata Unioni i Biznesit Farmaceutik tashmë ka prezencën e saj të re në botën e internetit nëpërmjet publikimit të faqes së re zyrtare në internet me adresën www.ubf.al

Faqja është ende në proces zhvillimi dhe përditësimi dhe çdo koment e sugjerim është i mirëpritur. Bashkë me faqen e re zyrtare, shoqata ka edhe një postë të re elektronike zyrtare, www.info@ubf.al ku mund të dërgoni pyetje dhe komente.

UBF e pranishme në konferencën vjetore të Urdhërit të Farmacistëve



Presidenti i UBF, z. Dorian Sadiku mori pjesë si folës nderi në hapjen e punimeve të Konferencës vjetore të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë. Në fjalën e tij z. Sadiku theksoi rëndësinë për krijimin e kushteve për bashkëpunim me të gjithë aktorët e industrisë së farmaceutikës.

Duke iu drejtuar të pranishmëve ai tha: “Unë besoj se ne jemi në një marrëdhënie simbiotike. Njëri nuk mund të bëjë pa tjetrin. Jemi hallka të rëndësishme të zinxhirit të gjatë të kujdesit shëndetësor. Dhe faktorë në sigurimin e një të mire publike, sikundër njihet kujdesi shëndetësor tashmë në botë.” Më pas ai foli për rolin e rëndësishëm që ka farmacisti në një botë që ka njohur ndryshime rrënjësore sidomos me pandeminë, krizën ekonomike dhe politike aktuale. “Përvoja nga vende europiane mund të shërbejë si pikënisje për modele ku roli i farmacistit është zgjeruar ose përshtatur me qëllim dhënien e një shërbimi të sigurt, cilësor dhe sa më pranë pacientit.”

Në vijim të fjalës z. Sadiku foli për pacientin i cili, në epokën e shoqërisë së informacionit dhe digjitalizimit, është më shumë i informuar dhe pret një tjetër nivel shërbimi krahasuar me të kaluarën e afërt. Në fund, Presidenti i shoqatës u fokusua te roli i ardhshëm i farmacistit, përshtatja përballë sfidave të së ardhmes dhe nevoja për një treg të ndershëm dhe në interes të sipërmarrjes dhe qytetarëve.

UBF e ftuar në komisionin parlamentar për punët, çështjet sociale dhe shëndetësinë

Në 19 dhjetor 2022, u mbajt seanca dëgjimore e Komisionit Parlamentar për Punët, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ku u diskutua mbi ligjin e ri për farmaceutikën.

Në seancë u ftua për t'u dëgjuar një përfaqësi nga shoqata Unioni i Biznesit Farmaceutik, e kryesuar nga z. Dorian Sadiku, z. Ilir Shehu dhe z. Sokol Topciu. Në fjalën e tij, z. Sadiku, President i shoqatës UBF, vlerësoi nismën e qeverisë për rishikimin e ligjit të barnave dhe shërbimin farmaceutik në Shqipëri.

Ai u ndal në disa mesazhe mbi ndryshimet në ligj si dhe për një qasje të re për të gjithë sistemin e kujdesit shëndetësor në sfondin e zhvillimeve gjatë dhe pas pandemisë Covid-19.

Ndër të tjera, z. Sadiku, u shpreh se: "Gjatë pandemisë, industria farmaceutike mbarti një barrë të konsiderueshme dhe me veprime konkrete treguam se tek ne nuk ka klientë, por vetëm pacientë. Industria jonë fokusohet tek pacienti dhe qytetari. T'u shërbesh qytetarëve do të thotë t'i shërbejmë vetes, prindërve tanë, vëllezërve dhe motrave tona, fëmijëve tanë."

UBF e ftuar në komisionin parlamentar për punët, çështjet sociale dhe shëndetësinë

Janar 2023

Ai gjithashtu foli për nevojën e një tregu të drejtë e funksional, sepse synimi i biznesit nuk është fitimi afatshkurtër, por siguria afatgjatë e funksionaliteti i sistemit shëndetësor për të gjithë shqiptarët. Duke u ndalur te mësimet e pandemisë, Z. Sadiku foli për rolin e rëndësishëm që luajtën dhe që mund të luajnë në të ardhmen trupa e farmacistëve dhe rrjeti i farmacive në përballimin e sfidave shëndetësore.

Digjitalizimi gjithashtu, lehtësoi në përballjen e pandemisë ndaj duhet të vijohet me konsolidimin e tij, në vazhden e projekteve si e-depo, e-receta e nënshkrimi elektronik, duke reflektuar mundësinë e përfshirjes së të gjitha medikamenteve në këto sisteme.

Lidhur me sfidat aktuale Z. Sadiku përmendi kohën e gjatë që një medikament që hyn në tregun ndërkombëtar, duhet të presë deri sa të hyjë në tregun shqiptar. "Nëse një bar gjendet në Janinë, Shkup, Podgoricë, apo Prishtinë nuk ka pse të mungojë në Gjirokastrë, Pogradec, Shkodër apo Kukës". Në vijim, ai foli për përshtatjen e shërbimeve farmaceutike sipas ofertës turistike sidomos gjatë sezonit turistik, si dhe përmbledhi shkurt disa sugjerime konkrete për përmirësimin e ligjit në fjalë.